



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 9

Prishtinë, më 2.6.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Afërdita Berisha-Shaqiri, Sevdije Lama, Nijazi Idrizi dhe Salih Morina.

Munguan : Etem Arifi dhe Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Shefki Kastrati (NDI), Lejla Selimi (OSBE), zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit dt. 30.5.2011,**
- 3. Caktimi i ekspertëve për projektligjet në Komision.**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 30.5.2011 nr. 8

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 30.5.2011 pa vërejtje.

3. Caktimi i ekspertëve të Komisionit për projektligjet në procedurë

Kryetari Nait Hasani njoftoi komisionin se për dy projektligjet në procedurë (Kadastrin dhe Regjistrin e Pronave) zyrtarët e NDI kanë shprehur gatishmëri të bashkëfinancojnë 50% me komisionin rreth angazhimit të dy ekspertëve. Në fillim ftoi dy kryesuesit e GP-ve të marin fjalën dhe të sugjerojnë për ekspertët, 4 CV e të cilëve janë dorëzuar nga stafi i komisionit në shkresat e materialit për mbledhje.

Liburn Aliu dhe **Nijazi Idrizi** shkurtimisht arsyetuan propozimet e tyre rreth përvojës së ekspertëve të propozuar, ndërkaq **Salih Morina** sqaroi se për Regjistrin e Pronave është sugjeruar nga përfaqësuesit e MMPH mos të angazhohet ndonjë ekspert për shkak se projektligji nuk është voluminoz dhe fakti se më 2013 parashihet të bashkohen këto dy ligje në një ligj, mirëpo duke u nisur nga fakti se ligji bazë ndryshohet për së treti herë sugjeroi që edhe për këtë projekt të angazhohet eksperti nga propozimet e sotme për ekspert, ngase kemi të bëjmë me të njëjtin lëmi. Ai përcjelli komisionit edhe sugjerimin e zyrtarëve të MMPH se këto dy projekte duhet të kalojnë sa më shpejt, për shkak të kushtëzimit me ndihma nga BE për këtë fushë.

Në vazhdim **Nait Hasani** bashkërisht me anëtarët tjerë rishikuan udhëzimin e kryesisë rreth caktimit të ekspertëve dhe pas konsultimeve edhe me përfaqësuesin e NDI **Shefki Kastrati** si bashkëfinancues, konstatoi se Komisioni me konsensus nxori këtë:

V E N D I M

- I. **Z. Përparim Ahmeti** nga Prishtina angazhohet për kohë të shkurtër si ekspert i jashtëm për projektligjin e Kadastrit, i cili poçes nuk pranon, si rezervë do të angazhohet z. **Nevzat Piraj** nga Gjlani.
- II. **Z. Skender Sina** nga Gjakova angazhohet për kohë të shkurtër si ekspert i jashtëm për p/l për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.2002/5 për themelimin e regjistrin të të drejtave të pronës së paluajtshme, i cili poçes nuk pranon, si rezervë do të angazhohet **Selatin Ismajli** nga Prishtina.
- III. Ngarkohen dy grupet punuese, koordinatori i komisionit dhe përfaqësuesi i NDI **Shefki Kastrati** që brenda dy ditë pune të përgatisin termat e referencës, ku definohen përgjegjësitë e ekspertit, kushtet e kompensimit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në Komision.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë **Kryetari Nait Hasani** propozoi të konsultohet komisioni rreth Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020 i cili plan është dërguar fillimisht në këtë komision për të shqyrtuar, pastaj të rekomandohet për mbledhjen plenare. **Komisioni kërkoi** që MMPH për mbledhjen e dt. 6 qershor, për pikën Të ndryshme, të dërgojë përfaqësuesin e saj dhe një përfaqësues nga Këshilli për Planifikim Hapësinor, për të arsyetuar dokumentin e dërguar në Kuvend i cili dokument-Plan, është shumë i rëndësishëm për zhvillimet e mëtejme mjedisore, ndërkaq edhe anëtarët e komisionit u sugjeruan të përgatitin vërejtjet deri të hënën, nëse kanë.

Mbledhja përfundoi në orën 11,45.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani**
